



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e IV-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.48/11

Prishtinë, më 14.02.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Munguan: Naser Osmani dhe Jelena Bontić.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza - Ministër i Financave, Shkelzen Sylja - Sekretar i Përhershëm në MFSK-së, Ramadan Islami, Juergen Schatz dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të Komisionit, më 01.02.2012;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së;
Të ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave dhe Agim Çeku , Ministër i FSK-së.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-89 për deminimin humanitar me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së;
7. Rishqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, propozoi që pika e katërt dhe pestë, të heqen nga rendi i ditës, pasi që projektligjet në fjalë, kanë nevojë të harmonizohen me ndryshimet që janë bërë në projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ATK-në, të cilin projektligj grupi punues e ka shqyrtuar dhe raporti me amendamente për këtë projektligj do të radhitet për shqyrtim në mbledhjen e radhës së komisionit.

Rendi i ditës miratohet me ndryshime. Pika e katërt dhe e pestë heqen nga rendi i ditës, dhe në vazhdim bëhet rirenditja e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të Komisionit dt. 01.02.2012

Hykmete Bajrami, thekoi se i ka disa vërejtje teknike në diskutimet e saja, për të cilat do të njoftojë stafin e komisionit për korrigjimet e caktuara.

Kryetarja, konstatoi se procesverbali miratohet me plotësimet që do të bëhen nga deputetja Hykmete Bajrami.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Kryetarja, njoftoi se ka pasur një takim me përfaqësuesit e FMN-së ku është diskutuar për ndikimet buxhetore të projektligjit, të cilët kanë sugjeruar që të gjithë përfituesit që kanë të drejtë në pensionin e FSK-së, të kenë mundësi të zgjedhin njërin nga përfitimet, pensionin që iu takoj me këtë ligj apo përfitimet tjera që parashihen me ligjet tjera në fuqi. Rekomandimi konkret është që në nenin 5, paragrafi 3, të fshihet fjalie “përveç pagesës financiare për kategorinë e invalidëve të luftës”. Si dhe rekomandimi tjetër është që të shtohet një paragraf i ri, që mund të futet në nenin 27, ku do të thuhet se në rast të ndonjë krize eventuale buxhetore dhe me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale, Qeveria të ketë të drejtë që me një vendim të reduktojë apo ndalojë beneficionet e garantuara nga ky ligj, që është një zgjidhje e ngjashme për kategoritë tjera të luftës, të rregulluar me ligjin për veteranet dhe invalidët. Ndërkaq amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Bedri Hamza, njoftoi se për këtë projektligj është diskutuar me FMN, është diskutuar edhe gjatë harmonizimit të buxhetit të vitit 2012 dhe implikimet financiare shtesë të vlerësuara për këtë projektligj janë të përfshira në buxhetin e Kosovës dhe janë kalkuluar shpenzimet edhe për vitet tjera. Sa i përket amendamenteve paraprakisht të propozuara nga kryetarja, që janë edhe rekomandime të FMN-së, ne si MF plotësisht i mbështesim dhe kjo është në funksion të ruajtjes së stabilitetit buxhetor, edhe pse nuk jemi në presim situata të vështira buxhetore që do të ndikonin në stopimin e ndarjes së pensioneve për këtë kategori dhe kategoritë tjera, madje as nuk kemi asnjë indikacion për krijimin e gjendje të këtyre. Megjithatë është pjesë e marrëveshjes me FMN, që ligjet që kanë implikime buxhetore të përmbajnë dispozita që garantojnë stabilitetin dhe sigurinë buxhetore.

Shkelzen Sylja, njoftoi se për këtë projektligj kanë pasur takim me përfaqësuesit e FMN-së ku janë harmonizuar shumë çështje, ku ndër tjera janë përcaktuar kriteret për përfitimin e beneficioneve, duke përfshirë edhe moshën për pjesëtarët e FSK-së. Kostoja nga përfitimet është kalkuluar dhe paraqitur në deklaratën financiare dhe nëse numri i pjesëtarëve që duhet të pensionohen i kalon vlerat e kalkuluara, kjo do të mund të bëhet vetëm me vendim të veçantë të qeverisë dhe sipas mundësive buxhetore. I

vetmi befefeficion që do të përfitojnë pjesëtarët e FSK-së është beneficione financiar, me përjashtim të kategorive të invalidëve të luftës.

Latif Gashi, pyeti a do të jetë çështje fakultative, zgjedhja e beneficioneve nga ana invalidëve të luftës?

Shkelzen Syla, në përgjigjen e parafolësit, theksoi se e vetmja kategori që do të gëzojnë pensione të dyfishta, janë kategoria e invalidëve të luftës që janë pjesëtarë të FSK-së.

Latif Gashi, pyeti përfaqësuesin e MFSK-së e është kalkuluar saktë sa i del paga një veterani të luftës nga pensioni i dyfishtë (si veteran i luftës dhe pjesëtar i FSK-së), dhe a është e përballueshme kjo për buxhetin e Kosovës?

Shkelzen Syla, njoftoi se konform përqindjes invalidët do të gëzojnë pensionet dhe njëkohësisht do të përfitojnë nga skema sociale. Përfitimet për veteranët që janë pjesëtarë të FSK-së, vlerësohet se është një dhuratë për shërbimin në këtë institucion, ndërsa pensioni invalidor dhuratë e invaliditetit që e kanë fituar në luftë.

Latif Gashi, përkundër respektit dhe vlerave për kategorinë e veteranëve të luftës për kontributin që kanë dhënë, unë mendojë që momentalisht nuk kemi mundësi buxhetore për beneficione të dyfishta dhe mbështes rekomandimet e FMN-së për dy amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Sali Asllani, theksoi se përkrah rekomandimet e FMN-së dhe vërtet është logjikë e cunguar për beneficione të dyfishta. Duhet që invalidët e luftës të zgjedhin njërin nga pensionet dhe do të duhej kriteret më të qarta, ku do të përcaktohej se ai që është invalid të përfitojë nga skema social për këtë kategori, dhe ai që është i aftë të punojë në FSK dhe të gëzojë beneficionet sipas këtij ligji. Përkundër respektit për këtë kategori do të duhej përkrahur rekomandimet racionale të FMN-së.

Shkelzen Syla, theksoi se është fjala për oficerë që kanë grada të larta dhe kanë dhënë kontribut të çmueshëm në FKS me përvojën dhe profesionalizimin e tyre dhe meritojnë shpërblim.

Hasime Krasniqi, përkundër respektit për kontributin e invalidëve të luftës dhe vullnetit për t'iu ndihmuar, duke ditur mundësitë buxhetore, theksoi që kjo kategori duhet të ketë mundësi të gëzojë njërin nga pensionet, kur dihet se asnjë kategoritë tjera të luftës nuk janë përfituese e dyfishtë e pensioneve. Mbështes sugjerimet e FMN-së dhe propozojë që të rregullohet qartë çështja e zgjedhjes së njërit prej pensioneve, në mënyrë që të mos miratojmë ligje, që mëpastaj nuk do të zbatoheshin në praktikë. Vërtetë është një ligji i një rëndësie të veçantë për një kategori të veçantë, por kemi edhe kategori tjera të luftës që 12 vite që janë pa punë dhe nuk kanë as pagë dhe as pensione.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni nxori këtë rekomandim:

REKOMANDIM

1. Projektligji për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 5, paragrafi 3.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1 (me shtatë vota Për, asnjë Kundër dhe dy Abstenime – Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi)

Neni 5, paragrafi 3, të fshihet teksti “**përveç pagesës financiare për kategorinë e invalidëve të luftës**”

Amendamenti 2 (me tetë vota Për, asnjë Kundër dhe një Abstenime – Hykmete Bajrami)

Neni 27, shtohet paragrafi i ri 2, me tekstin si në vijim:

2. Në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik apo që përndryshe të sigurojë ruajtjen e disiplinës fiskale publike, Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo beneficioni të siguruar me këtë Ligj, përfshirë beneficionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare, madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së për Projektligjin nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-89 për deminimin humanitar me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Rishqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja, njoftoi se vërejtjet e bëra nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, lidhur me dispozitat e projektligjit me rastin e shqyrtimit të tij, janë inkorporuar në amendamentet e riproceduar për shqyrtim nga komisionit funksional. Ndërkaq amendamentet tjera nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona